

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLË SË PARË TIRANË
Nr. 22438/4

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 5-shkurt 2002, unë Enkela Bajo, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Emmanuel Papathnassiou dhe Z. Stavros Tzouvelekis në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, për depozitim të Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin Nr. 22438, datë 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka për Ortak të Vetëm shoqërinë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA.

Me vendimet e datës 3 dhjetor 2001, të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA dhe Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, është marrë vendimi për:

- zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me kontribute në natyrë duke përfshirë asetet e shoqërisë "GLOBAL" SHPK të cilat i janë transferuar filialit "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK pas likuidimit të shoqërisë "GLOBAL" SHPK. Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK ka aktualisht një kapital themeltar në shumën prej 700.000 USD (shtatëqind mijë dollarë amerikane) plus 100.000 lekë ose e konvertuar në lekë 100.742.500 lekë (njëqind milionë e shtatëqind mijë e katërqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind lekë). Aksionerët kërkojnë nga Gjykata caktimin e një eksperti për vlerësimin e aseteve të shoqërisë;
- emërimin si Administratorë të filialit "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, të Z. Emmanuel Papathanassiou, shtetas grek, lindur në Orestiaia, Evroi, Greqi, më 4 qershor 1955, mbajtës i pasaportës nr. N 767529 dhe Z. Stavros Tzouvelekis, shtetas grek, lindur më 6 shkurt 1964, në Selanik, Greqi, mbajtës i pasaportës nr. N375867, të cilët do të përfaqësojnë shoqërinë bashkarisht ose vecas;
- ndryshimin e selisë së shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK në adresën e re: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pallati i Ri (Ilir Trebicka), Kati VI, ap. 18, Tiranë, Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;

- Depozitimin e Vendimeve të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA" SHA dhe Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK të datës 3 dhjetor 2001 ku është vendosur: zmadhimi i kapitalit të shoqërisë me kontribute në natyrë duke përfshirë asetet e shoqërisë GLOBAL SHPK të cilat i janë transferuar filialit ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK pas likuidimit të shoqërisë "GLOBAL" SHPK. Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK ka aktualisht një kapital themeltar në shumën prej 700.000 USD (shtatëqind mijë dollarë amerikane) plus 100.000 lekë ose e konvertuar në lekë 100.742.500 lekë (njëqind milionë e shtatëqind mijë e katërqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind lekë). Caktimin si ekspert për vlerësimin e kontributeve në natyrë të shoqërisë "GLOBAL" SHPK të Z. Berti Pasika; emërimin e Administratorëve të filialit "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK, të Z. Emmanuel Papathanassiou, shtetas grek, lindur në Orestiaia, Evroi, Greqi, më 4 qershor 1955, mbajtës i pasaportës nr. N 767529 dhe Z. Stavros Tzouvelekis, shtetas grek, lindur më 6 shkurt 1964, në Selanik, Greqi, mbajtës i pasaportës nr. N375867, të cilët përfaqësojnë shoqërinë bashkarisht ose vecas; ndryshimin e selisë së shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK në adresën e re: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pallati i Ri (Iliq Trebicka), Kati VI, ap. 18, Tiranë, Shqipëri.
- Urdhërohet zyra e Regjistrimit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

ENKELA BAJO

